

Vendim nr. 34 datë 12.06.2023

(V-34/23)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimimi, Marjana Semini, Marsida Xhaferllari, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datat 06.04.2023 dhe 12.06.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 24 (A) 2022 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: ANILA HOXHA

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

**KUVENDI I SHQIPËRISË,
KËSHILLI I MINISTRAVE,
MINISTRIA E BRENDSHME,
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË
SHTETIT,
AVOKATURA E SHTETIT**

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 240, datë 16.06.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Shfuqizimi i fjalisë “*Sekretaria e Gjykatës së Lartë shpall listat e shqyrtimit të rekurseve të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit*”, në nenin 482, paragrafi 3, të Kodit të Procedurës Civile, si e papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Shfuqizimi i fjalisë “*Sekretaria e gjykatës njofton me shpallje ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, si dhe përbërjen e trupit gjykues të paktën 15 ditë përpara*”, në nenin 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, si e papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, pika 1, 15, 17, 33, 41, 42, 43, 49, 52 dhe 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27, 39, 49, 71, 71/a dhe 76, pika 6, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuësës, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Kuvendit të Shqipërisë (*Kuvendi*), Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Brendshme (*ish-Ministria e Punëve të Brendshme*), Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Avokaturës së Shtetit, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuësja Anila Hoxha prej datës 05.01.2012 ka ushtruar detyrën e zëvendës drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit në Departamentin e Trajnimit Policor. Marrëdhënia e punës është ndërprerë si rezultat i nxjerrjes së urdhrit nr. 652, datë 15.11.2013 të ministrit të Brendshëm (*urdhri nr. 652/2013*), me të cilin kërkuësja është liruar nga detyra me motivacionin “Për shkurtim të funksionit organik dhe në pamundësi emërimi në detyrë tjetër”, bazuar në nenin 57, pika 2, të ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar (*ligji nr. 9749/2007*). Në këtë urdhër është disponuar, gjithashtu, se të drejtat administrative dhe financiare të kërkuësës ndërpriten në datën 20.11.2013, se ajo trajtohet financiarisht për ditët e pushimit vjetor të pakryer, ndërsa pas ndërprerjes së marrëdhënieve financiare, trajtohet financiarisht sipas nenit 12 të ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 10142/2009*).

2. Kërkuesja ka ngritur padi në gjykatë me objekt shfuqizimin e urdhrit nr. 652/2013 dhe detyrimin e Ministrisë së Brendshme dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit ta dëmshpërblenin me pagën që ajo do të përfitonte, deri në plotësimin e mandatit 4-vjeçar si zëvendës drejtoreshë e përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe ta trajtonin në përputhje me pikën 2 të nenit 25 të ligjit nr. 9749/2007 në datën e përfundimit të mandatit. Në themel të kërkesëpadisë kërkuesja ka pretenduar se lirimi nga detyra ishte bërë në kundërshtim me ligjin, në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe të justifikuara, ndonëse sipas nenit 25 të ligjit nr. 9749/2007 qëndrimi në detyrën e zëvendës drejtoreshë e përgjithshme të Policisë së Shtetit ishte për një periudhë 4-vjeçare, e cila përfundonte në datën 05.01.2016.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 223, datë 27.01.2014, ka vendosur pranimin e pjesës së padisë, duke detyruar Ministrinë e Brendshme ta dëmshpërblejë kërkuesen me pagën mujore deri në datën 05.01.2016, ndërsa kërkimet e tjera të padisë janë rrëzuar. Gjykata ka arsyetuar se kërkuesja nuk legjitimohej në ngritjen e kërimit për shfuqizimin e aktit administrativ, bazuar në vendimin unifikues nr. 31/2003 të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit rikthimi në punë i punonjësit të Policisë së Shtetit është në diskrecionin e administratës së policisë, që nuk i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor. Sipas gjykatës, kur konfirmohet qartësisht vullneti i organit publik për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, kontrata e shërbimit publik quhet e zgjidhur, ndërsa paligjshmëria e shkakut të zgjidhjes së kontratës i jep mundësi kërkueses të mbrohet vetëm për zgjidhjen e pasojave, ndaj vazhdimi i marrëdhënies së punës nuk mund të diskutohet ligjërisht. Me këtë arsyetim, gjykata ka konstatuar se ligji nr. 9749/2007 ka parashikuar shprehimisht rastet e largimit nga detyra përpara përfundimit të mandatit të zëvendës drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, tek të cilat nuk përfshihet ristrukturimi i organikës. Për pasojë, gjykata ka arritur në përfundimin se zgjidhja e kontratës së shërbimit të kërkueses ishte bërë pa shkak ligjor dhe se asaj i takonte vetëm dëmshpërblimi me pagën mujore deri në datën 05.01.2016, kur i përfundonte mandati 4-vjeçar. Gjithashtu, gjykata ka arsyetuar se kërkimi për t'u trajtuar me pagesë kalimtare pas datës 05.01.2016 ishte i pabazuar, pasi vullneti i punëdhënësit ishte për lirin nga detyra dhe trajtimin e kërkueses me pagesë kalimtare, ndaj për këtë kërkim nuk kishte mosmarrëveshje. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim kërkuesja, Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

4. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1164, datë 01.04.2014, ka vendosur ndryshimin pjesërisht të vendimit, duke pranuar edhe kërkimin për anulimin e urdhrit nr. 652/2013, ndërsa pjesa tjetër e vendimit është lënë në fuqi. Në ndryshim nga gjykata e shkallës së parë, gjykata e apelit ka vlerësuar se marrëdhënia e punës së kërkueses trajtohet

sipas ligjit të posaçëm nr. 9749/2007, ndaj urdhri i lirimit nga detyra ankimohet në gjykatë sipas nenit 78 të ligjit që parashikon të drejtën e punonjësit të policisë për t'iu drejtuar gjykatës me padi për anulimin e aktit, në rastet e parashikuara nga neni 57, pika 2, shkronja “b”, i të njëjtit ligj. Sipas saj, vendimi unifikues nr. 31/2003 është shprehur se marrëdhënia e punës së punonjësit të Policisë së Shtetit është shërbim publik dhe ky lloj punonjësi ka të drejtën të kërkojë gjyqësisht anulimin e aktit që i ndërpret marrëdhënien e punës dhe dëmshpërblimin, ndonëse nuk rikthehet në vendin e mëparshëm. Me këtë arsyetim, Gjykata Administrative e Apelit ka pranuar kërkimin për anulimin e urdhrit të lirimit nga detyra të kërkueses, për shkak se ishte nxjerrë në kundërshtim me ligjin për të njëjtat shkaqe, për të cilat gjykata e shkallës së parë kishte konstatuar paligjshmërinë e tij. Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit kanë paraqitur rekurs kundër vendimit, ndërsa kërkuësja ka paraqitur kundërrkurs.

5. Vendimi është lënë në fuqi nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i cili me vendimin nr. 00-2016-3211 (592), datë 20.12.2016, ka interpretuar ligjin nr. 9749/2007 lidhur me marrëdhënien e punës të zëvendës drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe rregullimin e pasojave të zgjidhjes së saj. Sipas Gjykatës së Lartë, lirimi dhe largimi (përrjashtimi) nga detyra i punonjësit të Policisë së Shtetit janë dy forma të ndryshme të ndërprerjes së marrëdhënies së punës me Policinë e Shtetit. Lirimi nga detyra nuk jepet në kuadrin e një mase disiplinore, ndaj shoqërohet me shpërblim (pagesë suplementare dhe pagë kalimtare). Zëvendës drejtori i përgjithshëm, ashtu si edhe drejtori i Përgjithshëm, janë pozicione të nivelit të lartë, drejtues të Policisë së Shtetit, ndaj rregullimi i tyre është thelbësishëm i ndryshëm në ligj nga pozicionet e tjera në këtë institucion. Me këtë arsyetim, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se, në kushtet kur neni 26 i ligjit nr. 9749/2007 nuk parashikon shprehimisht suprimimin e pozicionit dhe lirimin e zëvendës drejtorit të përgjithshëm, urdhri i lirimit të kërkueses nga detyra ishte në kundërshtim me ligjin, ndaj, me të drejtë, ishte anuluar nga Gjykata Administrative e Apelit. Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë, në ndryshim nga gjykatat e faktit, ka vlerësuar se në rastin e zëvendës drejtorit të përgjithshëm, e drejta për rikthimin në detyrë gëzon mbrojtje ligjore, pasi në bazë të nenit 25, pika 2, të ligjit nr. 9749/2007, individit kthehet në të njëjtën gradë që kishte përpara marrjes së detyrës, që do të thotë se marrëdhënia e punës së kërkueses nuk ishte me afat të caktuar 4-vjeçar. Mbi këtë bazë, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se gjykatat më të ulëta duhet të kishin urdhëruar, krahas dëmshpërblimit me pagën deri në përfundim të mandatit 4-vjeçar, edhe sistemimin e kërkueses në detyrën e mëparshme ose në një detyrë tjetër të të njëjtit nivel dhe gradë. Megjithatë, duke konstatuar se kërkuësja

nuk kishte paraqitur rekurs ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se nuk mund të vendoste rikthimin në punë të kërkuases.

6. Në datën 24.07.2014 kërkuessa i është drejtuar shërbimit përmbartimor privat për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në datën 12.06.2015 përmbartuesi gjyqësor ka njoftuar Degën e Thesarit Tiranë për vendosjen e masës së sekuestros konservative në llogarinë e thesarit të debitorit Ministria e Brendshme për shumën e detyrimit 788.120 lekë. Ndërsa me njoftimin e datës 12.01.2016, ai ka vënë në dijeni debitorët, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Ministrinë e Brendshme se edhe pse paga bruto e kreditorës ishte derdhur, ende nuk kishte një përgjigje për masat e marra për pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Për rrjedhojë, përmbartuesi ka konstatuar mospërmbushjen e detyrimeve në zbatim të vendimit nr. 1164, datë 01.04.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit. Po kështu, sipas përmbartuesit, duke qenë se nuk ka urdhër lirim për kërkuessen, ajo duhet të trajtohet për anën financiare në mënyrë të njëjtë me zëvendës drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Për këto arsye, përmbartuesi ka njoftuar debitorët të marrin masat e nevojshme për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

7. Në datën 23.11.2015 kërkuessa, me pretendimin se ligjërisht nuk ekziston një urdhër lirim për të dhe se mandati i përfundonte në datën 05.01.2016, i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit të pajisë zyrtarisht me urdhrin e lirimit nga detyra të zëvendës drejtores së përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe kryerjen e pagesës kalimtare për shkak të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.

8. Me shkresën nr. 1718/4-A prot., datë 17.12.2015, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit i është përgjigjur se kërkesa është në kundërshtim me urdhërimet e vendimeve gjyqësore nr. 223, datë 27.01.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe nr. 1164, datë 01.04.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit. Sipas saj, në pjesën arsyetuese të vendimeve, gjykatat kanë pranuar zgjidhjen e kontratës së shërbimit publik pa shkak të ligjshëm, duke zgjidhur në këtë mënyrë edhe pasojat e aktit të lirimit, pra trajtimin me pagë mujore deri më 05.01.2016. Në kushtet kur kërkuessa është dëmshpërblyer financiarisht me pagën mujore deri më 05.01.2016 dhe kur akti administrativ që i njihte të drejtën e pagës kalimtare është shfuqizuar nga gjykata, sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, kërkuessa nuk mund të përfitojë dy dëmshpërblime për të njëjtin fakt.

9. Kërkuessa i është drejtuar sërish Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi me objekt detyrimin e Ministrisë së Brendshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për nxjerrjen e urdhrit për lirim nga detyra, trajtimin me pagesë kalimtare, njohjen e periudhës 20.11.2013 - 05.01.2016 për efekt të pensionit të parakohshëm dhe

suplementar të pleqërisë sipas ligjit, si dhe kryerjen e pagesave të përcaktuara në urdhrat e përmbaruesit gjyqësor.

10. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 874 (80-2016-890), datë 29.02.2016, ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se mosmarrëveshja përbënte gjë të gjykuar. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesja.

11. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 3604, datë 12.10.2018, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë, pranimin e pjesshëm të padisë, duke detyruar Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit të nxjerrë urdhrin e lirimit të kërkueses, trajtimin e saj me pagesë kalimtare sipas ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, njohjen e periudhës 20.11.2013-05.01.2016 për efekt të pensionit të parakohshëm dhe pensionit suplementar të pleqërisë, si dhe rrëzimin e kërtimeve të tjera të padisë. Në dhënien e këtij vendimi ajo është bazuar edhe në arsyetimin e vendimit nr. 00-2016-3211 (592), datë 20.12.2016 të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur lënien në fuqi të vendimit gjyqësor për anulimin e urdhrit të lirimit nga detyra të kërkueses.

12. Mbi bazën e rekursit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1854 (240), datë 16.06.2022, në dhomën e këshillimit, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Sipas Gjykatës së Lartë, vendimi gjyqësor për anulimin e urdhrit të lirimit dhe zgjidhjen e pasojave të tij është i formës së prerë dhe ka efekte juridike me natyrë ekzekutuese për mosmarrëveshjen në proces, ndaj ajo përbën gjë të gjykuar.

13. Në datën 10.10.2022, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, si dhe të nenit 482, paragrafi 3, fjalia e parë, të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*) dhe nenit 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, (*ligji nr. 49/2012*), që parashikojnë mënyrën e njoftimit për procesin në Gjykatën e Lartë.

14. Me vendimin e datës 24.11.2022 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, si dhe thirrjen në këtë gjykim të palëve ndërgjyqëse, Ministrisë së Brendshme, Drejtorisë së Policisë së Shtetit dhe të Avokaturës së Shtetit, në cilësinë e subjekteve të interesuara. Në seancën plenare mbi bazë të dokumenteve të datës 06.04.2023, Gjykata, duke konsideruar se objekti i ankimit përfshin edhe kërkimin për shfuqizimin e akteve normative, në bazë të nenit 39, pika 1, shkronjat “b” dhe “c”, të ligjit nr.

8577/2000 vendosi thirrjen në cilësinë e subjektit të interesuar të Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave¹.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

15. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se nga aktet e kundërshtuara i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

15.1. *E drejta për t'u njoftuar*, pasi njoftimi me shpallje i listave të gjykimit dhe kohës së gjykimit prej sekretarisë së Gjykatës së Lartë, që parashikohet në nenet 482 të KPC-së dhe 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 bie ndesh me nenet 17, 33 dhe 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Shpallja publike është masë procedurale *ultima ratio*, vetëm kur gjykata nuk arrin të njoftojë palët personalisht dhe pasi i ka shteruar të gjitha mjetet e mundshme të njoftimit. Kërkuesja nuk ka marrë dijeni për ditën, datën dhe orën e gjykimit, ndonëse ka dhënë adresën e saktë të banimit dhe numrin e telefonit celular. Njoftimi me shpallje, edhe pse mund të jetë efektiv për ecurinë e procesit, nuk mund të mbizotërojë ndaj së drejtës për proces të rregullt ligjor dhe asaj për t'u dëgjuar përpara se të gjykoresh sipas nenit 33 të Kushtetutës. Gjykata e Lartë nuk ka respektuar as afatin ligjor 15-ditor të njoftimit, përderisa në dy rubrika të faqes zyrtare të saj ka të dhëna të ndryshme.

15.2. *E drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur*, pasi Gjykata e Lartë, duke mos e njoftuar personalisht kërkuesen, e ka lënë pa asnjë mundësi mbrojtjeje juridike, duke i mohuar të drejtën e ankimit ndaj mosveprimit administrativ.

15.3. *E drejta për t'u gjykuar brenda afatit të arsyeshëm*, pasi shqyrtimi i çështjes së kërkueses në Gjykatën e Lartë ka zgjatur pothuajse 4 vjet, duke tejkaluar afatin 90-ditor, të parashikuar nga neni 60, pika 2, të ligjit nr. 49/2012.

15.4. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor i lidhur me parimin e sigurisë juridike*, pasi Gjykata e Lartë ka gabuar kur e trajton çështjen si "*res judicata*". Kërkimi për trajtimin me pagesë kalimtare dhe trajtimin suplementar për kërkuesen nuk është gjykuar asnjëherë nga ndonjë trup gjykues, ndaj nuk mund të konsiderohet gjë e gjykuar. Kërkesa për pagesën kalimtare nuk mund të gjykohej nga gjykata në vitin

¹ Gjyqtarja Sonila Bejtja votoi kundër thirrjes në gjykim të këtyre subjekteve të interesuara

2014, pasi mosmarrëveshja administrative lindi në datën 05.01.2016 pas përgjigjes negative të Policisë së Shtetit. Gjykata e Lartë e ka ndaluar arbitrarisht kërkuesen që të kërkojë pension shtetëror, duke i kufizuar të drejtat sociale që i njeh legjislacioni në fuqi, sipas neneve 49 dhe 52 të Kushtetutës.

16. **Subjekti i interesuar, Kuvendi**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

16.1. Kërkuesja *nuk legjitimohet* për të kërkuar shfuqizimin e nenit 482, paragrafi 3, të KPC-së, pasi kjo normë nuk është e zbatueshme për mosmarrëveshjet gjyqësore administrative. Kërkuesja nuk ka paraqitur kundërrekurs dhe rikthimi i çështjes në Gjykatën e Lartë nuk i jep mundësinë e paraqitjes së pretendimeve shtesë, ndaj ajo nuk legjitimohet, pasi të drejtat e shkelura nuk mund të rivendosen. Po kështu, kërkuesja ka pranuar të njoftohet me anë të shpalljes, pasi nuk ka dhënë pëlqimin paraprak për njoftimin me postë elektronike.

16.2. Pretendimi se dispozitat ligjore të kundërshtuara janë në kundërshtim me Kushtetutën është haptazi i pabazuar, pasi *e drejta për proces të rregullt ligjor nuk cenohet*. Rregullat e ligjit nr. 49/2012 për njoftimin individual janë ndryshuar në vitin 2014 për të siguruar administrimin e mirë të proceseve gjyqësore dhe për të eliminuar vështirësitë praktike që haste Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Ligjvënësi ka synuar të shmangë tejzgjatjen e procesit gjyqësor, për më tepër që njoftimet nuk kanë vlerë të veçantë, për shkak se palët ndërgjyqëse nuk ftohen të marrin pjesë në gjykim në dhomën e këshillimit. Mënyra e njoftimit të gjykimit administrativ është e njëjtë me ato të gjykimeve penale dhe civile.

17. **Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit**, kanë paraqitur të njëjtat argumente dhe, në mënyrë të përmbledhur, kanë prapësuar si vijon:

17.1. Kërkuesja *nuk legjitimohet* për kundërshtimin e nenit 482, paragrafi 3, të KPC-së, pasi nuk provon se kjo dispozitë e cenon atë. Pretendimet mbi normat ligjore janë ngritur drejtpërdrejt në Gjykatë, ndaj kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion. Po kështu, kërkuesja nuk ka paraqitur argumente në nivel kushtetues për papajtueshmërinë e normave ligjore.

17.2. Pretendimet e kërkueses se normat ligjore të kundërshtuara cenojnë *të drejtën për proces të rregullt ligjor* në drejtim të aksesit në gjykatë janë të pabazuara. Kërkuesja ka qenë në dijeni të gjykimit në Gjykatën e Lartë, pasi asaj i është komunikuar rekursi i palës së paditur në procesin gjyqësor dhe sekretaria gjyqësore e asaj gjykate e ka njoftuar me shpallje për datën dhe orën e seancës, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012. Ligji parashikon

njoftimin individual kur individi ka lënë të dhënat e kontaktit elektronik në shkallët e tjera të gjykimit. Qëllimi i ligjvënësit në krijimin e gjykatave administrative ka qenë thjeshtimi i procedurave, me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, por duke garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshëm nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor dhe brenda afateve të arsyeshme.

17.3. Pretendimi për gjykimin e çështjes në Gjykatën e Lartë *tej afatit të arsyeshëm* është i pabazuar, pasi zgjatja e afatit ka ardhur si rezultat i reformës në drejtësi.

17.4. Pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* është i pabazuar. Në thelb, kërkesja nuk ka ngritur çështje të kushtetutshmërisë, por kërkon në mënyrë indirekte t'i jepet zgjidhje pretendimeve të saj në lidhje me themelin e mosmarrëveshjes. Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me kompetencat dhe tagrat ligjorë të saj kur ka vlerësuar se çështja ishte gjë e gjykuar, ndaj nuk ka cenuar parimin e sigurisë juridike.

18. **Subjekti i interesuar, Ministria e Brendshme,** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

18.1. Vendimi i Gjykatës së Lartë nuk është i papajtueshëm me Kushtetutën, pasi janë zbatuar rregullat e reja ligjore për njoftimin e palëve dhe shqyrtimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë në dhomën e këshillimit. Këto rregulla kanë rritur efikasitetin e njoftimit, duke mundësuar përshpejtimin e gjykimit të çështjeve në Gjykatën e Lartë. Për këtë arsye është i nevojshëm disiplinimi i palëve që të lënë adresën e tyre elektronike në momentin e depozitimit të rekursit, që ato të njoftohen po në rrugë elektronike.

18.2. Pretendimet e kërkuases për nxjerrjen e një urdhri të dytë nga Policia e Shtetit janë të pabazuara. Ajo nuk është as *de jure* dhe as *de facto* punonjëse efektive e Policisë së Shtetit që nga data e nxjerrjes së urdhrit të lirimit nr. 652/2013 të ministrit të Brendshëm. Pretendimet e kërkuases janë të natyrës ligjore dhe nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues.

18.3. Kërkesja është dëgjuar dhe ka pasur një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi. Aksesit në gjykatë ka qenë substantiv dhe jo thjesht formal.

19. **Subjekti i interesuar, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit,** ka prapësuar si vijon:

- 19.1. Mosnjoftimi individual i kërkueses nga Gjykata e Lartë nuk përbën shkelje të normave kushtetuese. Njoftimi konsiderohet i kryer me anë të shpalljes në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.
- 19.2. Kërkimi për shfuqizimin e dispozitave ligjore përbën abuzim me të drejtat procedurale kushtetuese, pasi cenimi i interesit individual të pretenduar nga kërkuesja ka ardhur si rrjedhojë e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë.
- 19.3. Pretendimet e kërkueses nuk janë kushtetuese. Ato kanë marrë zgjidhje përfundimtare nga Gjykata e Lartë. Kërkuesja mund t'i drejtohet Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për kërkesat paraprake

20. Kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me dy kërkesa paraprake, që lidhen me kohën e paraqitjes së prapësimeve nga subjekti i interesuar, Kuvendi, dhe me përmbajtjen e prapësimeve të subjektit të interesuar, Këshilli i Ministrave.

21. Në lidhje me kërkesën e parë, kërkuesja ka pretenduar se subjekti i interesuar, Kuvendi, i ka paraqitur parashtrimet e tij në kundërshtim me afatin e caktuar nga Gjykata dhe nuk ka kërkuar zgjatje të tij, ndaj e drejta për të paraqitur prapësime ka rënë në dekadencë dhe çdo material i paraqitur prej Kuvendit përtej datës 05.05.2023 nuk duhet të merret në konsideratë dhe as të analizohet nga Gjykata.

22. Gjykata vëren se sipas nenit 38, pika 6, të ligjit nr. 8577/2001, kur seanca zhvillohet mbi bazë të dokumenteve, mosparaqitja brenda afatit të përcaktuar dhe pa shkaqe të përligjura e parashtrimeve nga kërkuesi dhe e prapësimeve nga subjekti/et i/e interesuara passjell zhvillimin e gjykimit vetëm mbi bazën e kërkesës dhe/ose dokumenteve shoqëruese të saj të paraqitura në momentin e regjistrimit. Neni 28, pika 5, i Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës përmban të njëjtin rregull, por duke shtuar se Gjykata vendos ndryshe në rast se prania ose dëgjimi i palëve në seancë plenare vlerësohet i rëndësishëm për nevoja të gjykimit të çështjes.

23. Duke analizuar këtë kuadër normativ, Gjykata thekson se rregulli për pasojën e mosrespektimit të afatit synon të disiplinojë sjelljen e palëve në funksion të efektivitetit të gjykimit kushtetues. Për këtë arsye, Gjykata kujdeset që afatet e caktuara të jenë të arsyeshme për palët, ndërsa këto të fundit kanë detyrimin jo vetëm të respektimit të tyre, por edhe të njoftojnë zyrtarisht nëse verifikohet ndonjë rrethanë e përligjur që i pengon t'i respektojnë ato.

24. Në çështjen konkrete, subjekti i interesuar, Kuvendi, është thirrur nga Gjykata për të marrë pjesë në gjykimin kushtetues, duke vlerësuar se ishte i rëndësishëm dëgjimi i tij, në cilësinë e organit që ka miratuar normat ligjore të kundërshtuara. Ai është njoftuar me shkrim në datën 07.04.2023 për paraqitjen e propësimeve me shkrim brenda datës 05.05.2023, të cilat ai i ka depozituar në datën 24.05.2023. Këto propësime i janë njoftuar rregullisht dhe në kohën e duhur kërkuesses, e cila ka paraqitur edhe kundërargumente për to, jo vetëm për aspektin formal të afatit, por edhe për themelin e propësimeve. Në këtë situatë, Gjykata, duke ritheksuar rëndësinë e respektimit të afateve të caktuara prej saj nga të gjitha palët në proces, si dhe duke vlerësuar në tërësi rrethanat konkrete, çmon se kjo kërkesë paraprake nuk duhet pranuar.

25. Në lidhje me kërkesën e dytë paraprake, kërkuessa në parashtrimet e datës 25.05.2023 ka pretenduar se ajo pjesë e propësimeve të subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, që kundrejtohet ndaj procesit gjyqësor dhe vendimit të Gjykatës së Lartë, në të cilin ai nuk ka qenë palë ndërgjyqëse, nuk duhet të merren në konsideratë nga Gjykata.

26. Gjykata vë në dukje se me vendimin e saj të ndërmjetëm të datës 06.04.2023, bazuar në nenin 39, pika 1, shkronjat “b” dhe “c”, të ligjit nr. 8577/2000 është vendosur thirrja në cilësinë e subjekteve të interesuara të Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit, duke vlerësuar se kanë interes të drejtpërdrejtë në gjykimin kushtetues për kërkimin që lidhet me shfuqizimin e akteve normative, për shkak se në procesin ligjvënës ushtrojnë respektivisht kompetencat e propozimit dhe të miratimit të ligjeve. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se kërkesa paraprake e kërkuesses është e bazuar, ndaj do të shqyrtojë vetëm atë pjesë të propësimeve të Këshillit të Ministrave që lidhet me kontrollin e kushtetutshmërisë së nenit 482, paragrafi 3, fjalia e parë, të KPC-së dhe nenit 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012.

B. Për legjitimitimin e kërkuesses

27. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

28. Gjykata ka pohuar se bazuar në nenet 49, pika 3, shkronja “e” dhe 71, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, objekt i ankimit kushtetues individual, krahas vendimit gjyqësor, mund të jetë edhe ligji ose akti normativ. Në këto raste, nisur nga përmbajtja e normave kushtetuese dhe atyre ligjore, kërkuesi legjitimohet nëse plotësohen bashkërisht këto kriterë: (i) legjitimimi *ratione personae*, në kuptimin që individi provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar, si dhe provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese; (ii) shterimi i mjeteve juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose individi provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm; (iii) legjitimimi *ratione temporis*, në kuptimin që individi ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit; (iv) dhe legjitimimi *ratione materiae*, në kuptimin që individi provon se pretendimet e ngritura janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, pra të drejtat dhe liritë themelore, që pretendohen se janë cenuar, janë të garantuara në Kushtetutë, si dhe shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur (*shih vendimet nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Në çështjen konkrete, kërkuesja ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë, në të cilin ajo ka qenë palë ndërgjyqëse, si dhe përmbajtjen e neneve 482, paragrafi 3, të KPC-së dhe 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012. Në lidhje me vendimin e Gjykatës së Lartë, ajo ka pretenduar se është rrjedhojë e një procesi, për të cilin ajo nuk është njoftuar rregullisht dhe se Gjykata e Lartë, përmes mënyrës së interpretimit të ligjit dhe gjësë së gjykuar, i ka cenuar parimin e sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Për sa u takon dispozitave ligjore, kërkuesja ka pretenduar se ato nuk parashikojnë njoftimin individual, ndaj zbatimi i tyre i ka cenuar të drejtën për t’u njoftuar rregullisht, të drejtën për t’u dëgjuar e për t’u mbrojtur në atë gjykatë.

30. Subjektet e interesuara Kuvendi, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit kanë prapësuar se kërkuesja *nuk legjitimohet* për të kërkuar shfuqizimin e nenit 482, paragrafi 3, të KPC-së, pasi kjo normë nuk është e zbatueshme për mosmarrëveshjet gjyqësore administrative.

31. Gjykata vëren se procesi gjyqësor i kërkueses është me natyrë administrative, ndaj mënyra e njoftimit të palëve për gjykimin në Gjykatën e Lartë rregullohet nga ligji nr. 49/2012, dispozitat e të cilit plotësohen nga KPC-ja. Kështu, sipas nenit 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “*Sekretaria e gjykatës njofton me shpallje ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, si dhe përbërjen e trupit gjykues të paktën 15 ditë përpara*”. Në të njëjtën linjë, fjalja e parë e nenit 482, paragrafi 3, i KPC-së parashikon se “*Sekretaria e Gjykatës së Lartë shpall listat e shqyrtimit të rekurseve të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit*”, dhe më tej, po ky paragraf

parashikon se njoftimi për ditën, orën, si dhe përbërjen e trupit gjykues që shqyrton rekursin bëhet me shpallje në ambientet e Gjykatës së Lartë, si dhe në faqen e saj të internetit dhe me njoftim individual kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimit. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se neni 482, paragrafi 3, i KPC-së dhe neni 61, pika 2, i ligjit nr. 49/2012, që kundërshtohen nga kërkesja, nuk parashikojnë nxjerrjen e akteve nënligjore dhe zbatohen drejtpërdrejt nga Gjykata e Lartë në procesin që ajo zhvillon, duke përmblusur në këtë mënyrë kushtin e efektit të drejtpërdrejtë, që parashikohet nga neni 49, pika 3, shkronja “e”, i ligjit nr. 8577/2000. Ky kuadër ligjor është përdorur nga Gjykata e Lartë për të kryer njoftimin e kërkeses për çështjen e saj, duke shpallur në faqen zyrtare dhe në këndin e njoftimeve në ambientet fizike listën e gjykimeve për seancat gjyqësore, si dhe përbërjen e trupit gjykues, ku përfshihet edhe çështja e kërkeses.

32. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se kërkesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar, ndaj prapësimet e subjekteve të interesuara Kuvendi, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit në këtë drejtim janë të pabazuara.

33. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Kontrolli kushtetues ka natyrë subsidiare, që do të thotë se individi duhet t’i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Shterimi i mjeteve juridike përbën parakusht që duhet përmblusur nga kërkuuesi, i cili përpara se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike efektive të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Në çështjen konkrete, kërkesja, ndër të tjera, ka pretenduar cenimin e së drejtës për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm në Gjykatën e Lartë. Sipas saj, ndonëse neni 60, pika 2, i ligjit nr. 49/2012 parashikon se gjykimi duhet të përfundojë brenda 90 ditëve, çështja e saj është shqyrtuar pothuajse për një periudhë prej 4 vjetësh, sepse është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 26.12.2018 dhe ka përfunduar në datën 16.06.2022. Ky pretendim i kërkeses është prapësuar nga subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, si i pabazuar, me argumentin se kohëzgjatja e gjykimit është rezultat i faktorëve objektivë të njohur dhe të pranuar nga

jurisprudenca kushtetuese dhe se situata lidhet me gjendjen objektive të shkaktuar nga reforma në drejtësi.

35. Gjykata evidenton se me ndryshimet që i janë bërë KPC-së me ligjin nr. 38/2017, hyrë në fuqi më 05.11.2017, është përcaktuar, ndër të tjera, se cilat konsiderohen afate të arsyeshme (*neni 399/2*), cili konsiderohet shpërblim i drejtë (*neni 399/3*), cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes dhe përsheptimin e procedurave (*nenet 399/4 dhe 399/6*), përfshirë rregullat për gjykimin e kërkesës (*neni 399/7*). Në këtë mënyrë, ligji procedural ka parashikuar mjete ligjore për t'i garantuar individit mbrojtjen e së drejtës për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm, të cilat sipas jurisprudencës së kësaj Gjykate në parim janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret (*shih vendimet nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Në rastin në shqyrtim, kërkesja nuk rezulton t'i ketë përdorur mjetet ligjore të parashikuara nga *nenet 399/1* e vijues të KPC-së për të mbrojtur të drejtën kushtetuese të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Ajo e ka ngritur këtë pretendim për herë të parë në ankimin kushtetues dhe nuk ka paraqitur ndonjë argument se përse nuk e ka përdorur “kërkesën për përsheptim drejtuar Gjykatës së Lartë”, pra nëse ky mjet ka qenë joefektiv në rastin e saj. Për rrjedhojë, në lidhje me këtë pretendim, Gjykata çmon se kërkesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, në kuptim të *nenit 131, pika 1, shkronja “f”*, të Kushtetutës dhe *nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”*, të ligjit nr. 8577/2000.

37. Ndërsa për pretendimet e tjera që kanë të bëjnë me cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektet e të drejtave për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, si dhe standardit të arsyetimit të vendimit të lidhur me parimin e sigurisë juridike, kërkesja ka parashtruar se pasoja antikushtetuese i ka ardhur gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë, vendimi i së cilës mund të ankimohet vetëm në Gjykatën Kushtetuese. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se për këto pretendime plotësohet kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive, pasi kërkesja nuk ka mjete të tjera juridike në dispozicion, përveç ankimit kushtetues individual. Për rrjedhojë, është i pabazuar prapësimi i subjekteve të interesuara, Këshillit të Ministrave dhe Avokaturës së Shtetit, se kërkitimi për kushtetutshmërinë e dispozitave ligjore duhet të ishte ngritur nga kërkesja më përpara në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në mënyrë që Gjykata e Lartë të shprehej nëse ato paraqesin probleme kushtetutshmërie.

38. Gjykata çmon se kërkesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi përfundimtar i Gjykatës së Lartë mban datën 16.06.2022, kurse ankimi kushtetues individual

është paraqitur në datën 10.10.2022, brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr.8577/2000.

39. Në vijim, Gjykata vlerëson se kërkesja legjitimohet *ratione materiae*, pasi: (i) pretendimet për cenimin e të drejtave për t’u njoftuar, mbrojtur dhe dëgjuar; (ii) dhe pretendimi për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit në lidhje me parimin e sigurisë juridike garantohej nga neni 42 i Kushtetutës, ndaj hyjnë në kompetencën e Gjykatës, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

40. Për sa i takon grupit të parë të pretendimeve, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se argumenti kryesor i kërkueses lidhet me pamundësinë e saj për t’u dëgjuar dhe mbrojtur nga Gjykata e Lartë, do t’i shqyrtojë ato në këndvështrimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për mbrojtje efektive. Çështja në shqyrtim lidhet me faktin nëse kërkesja, për shkak të mënyrës së njoftimit të parashikuar nga ligji dhe të zbatimit të tij në praktikë, është penguar të dëgjohet dhe mbrohet efektivisht në Gjykatën e Lartë, e cila ka vendosur në disfavor të saj. Për pasojë, Gjykata duhet të analizojë nëse asaj i është kufizuar aksesit në atë masë që i ka cenuar thelbin e së drejtës së mbrojtjes. Pas shqyrtimit të këtij grupi pretendimesh, Gjykata do të analizojë edhe pretendimin për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e sigurisë juridike për konceptin e gjësë së gjykuar.

C. Për themelin e pretendimeve

C.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me të drejtën për mbrojtje efektive

41. Kërkesja pretendon se mënyra e njoftimit me shpallje, e parashikuar nga nenet 482, paragrafi 3, të KPC-së dhe 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, si dhe mosveprimi në kohën e mënyrën e duhur nga Gjykata e Lartë në lëshimin e njoftimeve, i ka cenuar të drejtat për t’u njoftuar rregullisht, për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur në Gjykatën e Lartë. Sipas saj, vërtet njoftimi me shpallje mund të jetë një masë efektive për ecurinë e procesit, por nuk mund të mbizotërojë ndaj së drejtës për proces të rregullt ligjor dhe së drejtës për t’u dëgjuar. Njoftimi me shpallje nuk mund të jetë rregull i vetëm, i menjëhershëm dhe i detyrueshëm njoftimi. Ajo ka pretenduar, gjithashtu, se Gjykata e Lartë, duke mos e njoftuar personalisht, e ka lënë pa asnjë mundësi mbrojtjeje juridike dhe i ka mohuar abuzivisht të drejtën e ankimit ndaj mosveprimit administrativ. Gjykata e Lartë nuk ka respektuar as afatin ligjor 15-ditor të njoftimit, përderisa në dy rubrika të faqes zyrtare të saj ka të dhëna të ndryshme. Sipas saj, duke mos marrë dijeni për ditën, datën dhe orën e gjykimit, kërkesja nuk ka pasur mundësi të njihet me trupin gjykues, të parashtrojë kërkesa për përjashtim të gjyqtarëve të trupit gjykues dhe për

numrin e anëtarëve të trupit gjykues që duhet të shqyrtonte çështjen, të paraqesë memo për zhvillimet më të fundit ligjore dhe jurisprudenciale, vendase dhe të huaja, të zbatueshme sipas objektit të mosmarrëveshjes.

42. Subjektet e interesuara, Kuvendi, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit kanë prapësuar se njoftimi me shpallje, që parashikon ligji, synon miradministrimin e proceseve gjyqësore administrative dhe nuk cenon të drejtën e aksesit në gjykatë. Sipas tyre, ligji thjeshton procedurat, duke garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshëm nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor dhe brenda afateve të arsyeshme.

43. Subjekti i interesuar, Ministria e Brendshme, ka prapësuar se për shkak të numrit të madh të çështjeve që presin për t'u gjykuar në Gjykatën e Lartë, njoftimi i palëve personalisht do të sillte kosto të pajustificuara dhe vonesa, ndaj palët duhen disiplinuar që të lënë adresat elektronike në momentin e depozitimit të rekursit, që të njoftohen elektronikisht. Edhe subjekti i interesuar, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ka prapësuar se pretendimi i kërkuësës është i pabazuar, pasi njoftimi për procesin në Gjykatën e Lartë konsiderohet i kryer në momentin e publikimit të tij në sistemin *online*.

44. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. Ndërsa në nenin 17 të saj gjendet parimi i përgjithshëm, që lejon kufizimin e të drejtave kushtetuese, me kusht që kufizimi të bëhet vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, si dhe të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Kufizimi nuk mund të cenojë thelbin e së drejtës, e, në asnjë rast, nuk mund të tejkalojë kufizimet e parashikuara në KEDNJ.

45. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, e cila nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur një zgjidhje gjyqësore përfundimtare për mosmarrëveshjen. Nëse mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet nr. 7, datë 21.02.2023; nr. 9, datë 07.02.2017; nr. 18, datë 31.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

46. E drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të janë të lidhura me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. Nga njëra anë, kjo e drejtë u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim

krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 13, datë 20.02.2017; nr. 21, datë 04.04.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

47. Gjykata ka pranuar në jurisprudencën e saj se e drejta e aksesit në gjykatë nuk është absolute dhe ajo mund të jetë objekt i kufizimeve, me kusht që të mos cenohet thelbi i së drejtës. Një kufizim nuk do të jetë në përputhje me Kushtetutën nëse nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nëse nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet (*shih vendimin nr. 26, datë 27.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

48. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se pretendimet për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën e mbrojtjes efektive bazohen në faktin e parregullsisë së njoftimit për datën e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë, si pasojë e dy shkaqeve: (i) përmbajtjes së normave ligjore të kundërshtuara; (ii) dhe mënyrës së zbatimit të rregullave nga administrata e Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, Gjykata do t'i shqyrtojë ato, duke analizuar fillimisht kushtetutshmërinë e dispozitave ligjore, për të vijuar me vlerësimin kushtetues të mënyrës së zbatimit të tyre.

C.1.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën e mbrojtjes efektive, për shkak të përmbajtjes së ligjit

49. Gjykata vëren se fjalja e parë e nenit 482, paragrafi 3, të KPC-së dhe nenit 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 parashikojnë njoftimin me shpallje të palëve për procesin që zhvillohet në Gjykatën e Lartë, duke mos u shprehur për njoftimin individual të tyre. Në këtë kuptim, njoftimi individual i palëve nuk është detyrim për Gjykatën e Lartë, përveçse kur ata kanë depozituar të dhënat elektronike, ndaj kjo mënyrë njoftimi ndërhyt në të drejtën e aksesit në gjykatë të lidhur me të drejtën e mbrojtjes efektive. Për rrjedhojë, Gjykata do ta vlerësojë çështjen sipas kriterëve të nenit 17 të Kushtetutës, të cilat u japin përgjigje pyetjeve nëse kufizimi është bërë me ligj, nëse ekziston interesi publik dhe nëse ndërhyrja është në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

50. Për sa i takon kriterit “*kufizimi vetëm me ligj*”, Gjykata çmon se ai është përmbushur në rastin konkret. Kufizimi është bërë me dispozitat ligjore përkatëse të KPC-së dhe ligjit nr. 49/2012, të cilat janë miratuar nga Kuvendi, sipas procedurave të parashikuara për këtë qëllim.

51. Lidhur me kriterin e “*interesit publik*”, Gjykata në praktikën e vazhdueshme të saj, ka pohuar se ky koncept është mjaft i gjerë dhe duhet parë në këndvështrimin e aktit konkret që paraqitet për kontroll përpara saj. Është e vështirë të radhiten në mënyrë shteruese çështjet që përbëjnë interes publik ose të arsyes publike që çojnë në kufizimin e një të drejte themelore,

pasi interesi publik duhet kuptuar në sensin relativ, në varësi të situatave të ndryshme që krijohen. Ato mund të renditen vetëm negativisht, pra në aspektin e kufizimit të çdo rasti konkret. Në praktikën kushtetuese tashmë është pranuar se ligjvënësi, parimisht, është i lirë të veprojë brenda hapësirës së tij normuese, duke përcaktuar qartë dhe rast pas rasti qëllimet që kërkon të arrijë (*shih vendimet nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 16, datë 01.03.2017; nr. 1, datë 16.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

52. Gjykata vëren se dispozitat ligjore të kundërshtuara në çështjen konkrete parashikojnë njoftimin e palëve për datën, orën e gjykimit, si dhe përbërjen e trupit gjykues, të paktën 15 ditë përpara, nga sekretaria e Gjykatës së Lartë, nëpërmjet shpalljes në ambientet e gjykatës, në faqen elektronike zyrtare të internetit dhe kur palët kanë adresa elektronike të deklaruara ose të njohura, sekretaria kryen njoftimin individual të palëve edhe në këto adresa. E njëjta mënyrë e njoftimit të palëve parashikohet edhe në procesin që zhvillohet në gjykatën e apelit (neni 49, pika 2, i ligjit nr. 49/2012). Kjo mënyrë njoftimi duket se ka lidhje me procedurat e shqyrtimit të akteve të ankimit në këto gjykata, të cilat, si rregull, zhvillohen në dhomën e këshillimit, mbi bazë të dokumenteve, por gjithnjë duke u dhënë mundësinë palëve që të njihen me apelin/rekursin e palës tjetër dhe të parashtrajnë prapësimet/argumentet e tyre. Zhvillimi i seancës publike është përjashtim nga rregulli dhe vendoset vetëm për shkaqe të përcaktuara në ligj.

53. Referuar *travaux preparatoires* të miratimit të akteve që kanë sjellë ndryshime në dispozitat ligjore të kundërshtuara dhe konkretisht relacionet shoqëruese të projektit të ligjit nr. 38/2017 dhe nr. 100/2014 (ky i fundit plotësuar edhe me ndryshimet me ligjin nr. 49/2021), Gjykata konstaton se synimi kryesor i ligjvënësit ka qenë rritja e efektivitetit të sistemit të drejtësisë dhe miradministrimi i proceseve gjyqësore administrative. Kështu, sipas akteve të miratimit të ligjeve, ekzistenca e detyrimit ligjor për të kryer njoftimin “njësoj si në shkallë të parë”, ka sjellë pamundësinë e Kolegjit Administrativ për të zhvilluar seancat e planifikuara për shkak se në datën e zhvillimit të gjykimit, palët ndërgjyqëse nuk kanë marrë njoftimin për arsye të ndryshme, duke përbërë një pengesë serioze në zhvillimin e gjykimeve sipas kalendarit të miratuar, çka e ka detyruar Kolegjin Administrativ të shtyjë seancën gjyqësore në një datë tjetër. Me anë të njoftimit me shpallje në ambientet e Gjykatës së Lartë dhe njëkohësisht edhe në faqen zyrtare po të kësaj gjykate, shmanget tejzgjatja e procesit gjyqësor, për më tepër që njoftimet nuk kanë vlerë të veçantë për shkak se palët ndërgjyqëse nuk ftohen të marrin pjesë në gjykim në dhomën e këshillimit. Në këto kushte, njoftimi në mënyrat e tjera që kryen Gjykata e Lartë për çështjet me natyrë penale e civile nuk sjell cenimin e së drejtës së palëve për një proces të rregullt ligjor (*shih faqet 4 – 5 të relacionit të ligjit nr. 100/2014*).

54. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se ligjvënësi në miratimin e dispozitave ligjore të kundërshtuara ka përcaktuar qartë synimin e tij për rritjen e efikasitetit në procesin gjyqësor që zhvillohet në Gjykatën e Lartë, duke pasur parasysh kompetencat e saj dhe natyrën e procedurave të gjyqësorit që ajo zhvillon. Kjo mënyrë njoftimi duket se ofron edhe shpejtësi në gjykim, që i përgjigjet situatës aktuale të sistemit të drejtësisë, që karakterizohet nga volumi i lartë i çështjeve në pritje për t'u shqyrtuar. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ndërhyrja e ligjvënësit në të drejtën e aksesit të lidhur me të drejtën e mbrojtjes efektive, mbart interes publik.

55. Në lidhje me kriterin e *“përpjesëtimin të kufizimit me gjendjen që e ka diktuar”*, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se bëhet fjalë për parimin e proporcionalitetit, në thelb të të cilit qëndron ekuilibrimi i drejtë i interesave, vlerësimi objektiv i tyre, si dhe shmangia e konfliktit nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre. Për vlerësimin e tij duhen mbajtur në konsideratë disa kërkesa: (i) Nëse objektivi i ligjvënësit është mjaftueshmërisht i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës; (ii) nëse masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin, ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta ose të bazuara mbi vlerësime alogjike; (iii) nëse mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra se sa duhet për të arritur objektivin e kërkuar, sa më të mëdha efektet e dëmshme të masës së përzgjedhur, aq më tepër duhet të jetë i rëndësishëm objektivi për t'u arritur, në mënyrë që masa të justifikohet si e nevojshme. Proporcionaliteti i një kufizimi vlerësohet rast pas rasti, duke pasur parasysh që kriteret e mësipërme të mos analizohen veç e veç, por të gërshtuara me njëra-tjetrën (*shih vendimet nr. 15, datë 22.06.2022; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 11, datë 09.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

56. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se kërkesja ka pretenduar se çështja e saj është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 26.12.2018 dhe është shqyrtuar në datën 16.06.2022, duke tejkaluar afatin 90-ditor të përcaktuar nga neni 60, pika 2, i ligjit nr. 49/2012. Sipas kërkeses, njoftimi me shpallje nënkupton se ajo duhet të kalonte te stenda e Gjykatës së Lartë çdo ditë përreth 4 vjet dhe të kërkonte çdo ditë në internet nëse çështja e saj është njoftuar me shpallje për gjykim ose jo. Kjo është një barrë shumë e rëndë dhe aspak proporcionale për kërkesen, si dhe objektivisht e pamundur të realizohet praktikisht, veçanërisht kur fluksi i njoftimeve në Gjykatën e Lartë është me dhjetëra çdo ditë.

57. Gjykata çmon se dispozitat e kundërshtuara nga kërkesja, që parashikojnë mënyrën e njoftimit me shpallje të palëve për datën e shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit, lidhen në mënyrë të arsyeshme me objektivin e ligjvënësit për të siguruar efikasitetin e proceseve gjyqësore, përfshirë shpejtësinë e tyre. Kjo masë nuk duket se vendos ndonjë barrë të tepërt për

individin, palë në procesin gjyqësor, duke qenë se detyrimi për publikimin e njoftimeve në faqen e internetit të gjykatës, përveç atij për shpalljen në ambientet fizike të saj, shoqërohet edhe me mundësinë e njoftimit individual, kur vetë individi depoziton të dhënat elektronike të kontaktit të tij. Lidhur me këtë të fundit, në kushtet e zhvillimit të sotëm shoqëror, ku individi ka qasje të lehtë në internet dhe mjete elektronike, Gjykata vlerëson se bëhet fjalë për mundësi reale në dispozicion të individit, i cili me vullnetin e tij të lirë zgjedh që, krahas shpalljes publike, të njoftohet edhe individualisht. Në këto rrethana, mënyrat e parashikuara nga ligji përbëjnë një mjet efektiv për qëllimin e synuar. Duke qenë një masë e arsyeshme dhe e përshtatshme, ajo nuk e shndërron kufizimin e së drejtës së aksesit të lidhur me atë të mbrojtjes efektive, në arbitrar, për sa kohë që nuk cenohet thelbi i saj.

58. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuases për cenimin e së drejtës së aksesit i lidhur me të drejtën për mbrojtje efektive, për shkak të përmbajtjes së neneve 482, paragrafi 3, fjalia e parë, të KPC-së dhe 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, është i pabazuar.

C.1.2. Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën e mbrojtjes efektive, për shkak të mënyrës së zbatimit të ligjit

59. Gjykata ka pohuar në mënyrë konstante se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022. nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata, duke ndjekur edhe qasjen e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), ka theksuar se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Thënë ndryshe, Gjykata vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

60. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se çështja e kërkuases është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 26.12.2018 mbi bazën e rekursit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit ndaj vendimit të gjykatës së apelit. Sipas dëftesës së komunikimit të lëshuar në datën 07.11.2018, rekursi i është komunikuar kërkuases rregullisht

në datën 09.11.2018, megjithatë ajo ka zgjedhur të mos paraqiste kundërrekurs. Gjykata e Lartë ka vendosur që shqyrtimi i çështjes të zhvillohej në dhomën e këshillimit në datën 15.06.2022.

61. Për të realizuar njoftimin e palëve, përfshirë atë të kërkueses, 15 ditë përpara seancës, konkretisht në datën 31.05.2022, sekretaria e Gjykatës së Lartë ka kryer njoftimin me shpallje në dy mënyra: (i) në ambientet e Gjykatës së Lartë është shpallur lista e çështjeve që do të shqyrtoheshin në dhomën e këshillimit në datën 15.06.2022, si dhe përbërja e trupit gjykues, ku përfshihej edhe çështja e kërkueses; (ii) dhe njoftimi me listë çështjesh që tregonte kohën e gjyqimit dhe përbërjen e trupit gjykues është publikuar edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në rubrikën *“Çështje të shpallura për gjykim”*, për kategorinë *“Çështje administrative”*, nënrubrika *“Për shqyrtim në dhomë këshillimi”*.

62. Gjykata vëren më tej se, sipas të dhënave të sistemit elektronik, në rubrikën *“Njoftime për publikun”*, në datën 15.06.2022 është publikuar *“Informacion për shtyrjen e çështjeve administrative të planifikuara për shqyrtim në dhomë këshillimi”*, përmes të cilit është bërë njoftimi se: *“Të gjitha çështjet administrative të shpallura për shqyrtim në dhomë këshillimi, datë 15.06.2022, do të shtyhen për në datën 16.06.2022”*. Po në këtë rubrikë, në datën 16.06.2022 është publikuar *“Informacion mbi çështjet administrative të datës 16.06.2022”*, përmes të cilit është dhënë informacion edhe për përfundimin e çështjeve administrative për shqyrtim në dhomën e këshillimit në këtë datë, ku jepen të dhëna edhe për çështjen e kërkueses. Sipas këtyre të dhënave, Gjykata e Lartë në çështjen e kërkueses ka vendosur prishjen e vendimit nr. 3604, datë 12.10.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 874 (80-2016-890), datë 29.02.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

63. Duke zbatuar standardet kushtetuese në kontekstin e fakteve të çështjes konkrete, Gjykata vlerëson se sekretaria e Gjykatës së Lartë ka përmbushur detyrimet ligjore të shprehura në nenin 61 të ligjit nr. 49/2012 dhe nenin 482, paragrafi 3, të KPC-së. Kjo mënyrë njoftimi nuk e ka vendosur kërkuesen në pozita të pafavorshme ose të ketë ndikuar në mohimin e së drejtës së aksesit, në kuptimin substancial të saj, pasi, nga njëra anë, Gjykata e Lartë e ka realizuar komunikimin e këtyre të dhënave nëpërmjet afishimit në këndin e njoftimeve në ambientet fizike të saj, si dhe faqes elektronike zyrtare dhe, nga ana tjetër, rekursi i është njoftuar rregullisht asaj, duke i dhënë në këtë mënyrë mundësinë për t’u njohur dhe mbrojtur përkundër pretendimeve të palës tjetër ndërgjyqëse. Për rrjedhojë, në kushtet kur Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me dispozitat procedurale për njoftimin e palëve, procesi gjyqësor i zhvilluar prej saj nuk vë në dyshim të drejtën për proces të rregullt ligjor, në drejtim të së drejtës për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur efektivisht.

64. Për sa i takon pretendimit të kërkuësës për cenimin e së drejtës së aksesit dhe të mbrojtjes, për shkak se nuk është njoftuar për përbërjen e trupit gjykues, nuk është njohur me trupin gjykues dhe nuk ka mundur të parashtrojë kërkesë për përjashtimin e gjyqtarëve të trupit gjykues nga gjykimi i çështjes së saj, në shtesë të konstatimeve për rregullsinë e njoftimit të kërkuësës, Gjykata vëren, gjithashtu, se vendimi i këshillit të Gjykatës së Lartë nr. 8/2022 që ka përcaktuar përbërjen e kolegjeve të asaj gjykate, gjendet i publikuar në faqen zyrtare elektronike në rubrikën “Gjykata - Organizimi juridik - Këshilli i Gjykatës - Vendime”. Në rastin konkret, çështja që i përket kërkuësës është shqyrtuar nga trupi gjykues i Kolegjit Administrativ dhe përbërja e këtij kolegji është publike dhe e aksesueshme, si nga palët, ashtu edhe nga çdo person tjetër i interesuar. Për më tepër, nuk rezulton që kërkuësja të ketë argumentuar në mënyrë konkrete nëse ka ndonjë rrethanë ose fakt për ndonjë prej anëtarëve të Gjykatës së Lartë ose të Kolegjit Administrativ në veçanti, ndaj Gjykata çmon se ky pretendim për shkak të natyrës së përgjithshme dhe abstrakte është i pabazuar.

65. Lidhur me pretendimin e kërkuësës se Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar personalisht, ndonëse ajo kishte dhënë numrin e saj të telefonit celular, Gjykata vëren se nenet 128 – 144 të KPC-së parashikojnë mënyrat e njoftimit të akteve, ndër të cilat neni 141 rregullon njoftimin elektronik. Po kështu, Gjykata vëren se bazuar në nenin 141 të KPC-së, zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë ka nxjerrë urdhrin administrativ nr. 131, datë 02.07.2021 “Për publikimin e datave të gjykimeve dhe njoftimin e palëve” (*urdhri administrativ nr. 131/2021*), në pikën 5 të të cilit parashikohet se kur sekretaria gjyqësore konstaton se palët kanë deklaruar si të dhënë kontakti adresën e postës elektronike (*e-mail*), duhet të bëjë edhe njoftimin elektronik për datën e gjykimit. Në vlerësimin e Gjykatës, njoftimi elektronik është një alternativë e re ligjore, përdorimi i së cilës duhet nxitur, pasi i përgjigjet jo vetëm nevojës për shpejtësi në procedura, por edhe problematikave të shfaqura në jetën e përditshme nga lëvizjet demografike dhe sistemi ende i pakonsoliduar i adresave të qytetarëve.

66. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se kërkuësja ka depozituar vetëm numrin e telefonit celular, i cili nuk përfshihet në konceptin e të dhënës së kontaktit “adresë e postës elektronike”, referuar përmbajtjes së urdhrit administrativ nr. 131/2021 të zëvendëskryetarit të Gjykatës së Lartë. Në kushtet kur ajo nuk ka deklaruar në aktet drejtuar Gjykatës së Lartë adresën e postës elektronike të saj, atëherë Gjykata çmon se pretendimi i saj është i pabazuar.

67. Në përmbledhje të të gjitha argumenteve të mësipërme, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuësës për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për mbrojtje efektive, për shkak të zbatimit të ligjit, është i pabazuar.

C.2. Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e sigurisë juridike.

68. Kërkesja ka pretenduar cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e sigurisë juridike, pasi gjykatat kanë gabuar si në kuptimin e kërkesës, ashtu edhe në arsyetimin e rrëzimit të saj, duke e interpretuar në kundërshtim me ligjin objektin e padisë si “kërkesë për të nxjerrë një urdhër të dytë lirimi”. Sipas saj, duhet të ketë domosdoshmërisht një akt administrativ të lirit të saj nga radhët e Policisë së Shtetit dhe mbarimi i mandatit nuk duhet të interpretohet si përfundim ekstraligjor i marrëdhënies së karrierës në Policinë e Shtetit. Gjithashtu, ajo pretendon se gjykata gabon kur e trajton këtë çështje si “*res judicata*”, pasi çështja e trajtimit me pagesë kalimtare dhe trajtimi suplementar përbën një mosmarrëveshje gjyqësore dhe nuk përbën mosmarrëveshje administrative. Në kundërshtim me këtë parim, Gjykata e Lartë e ka ndaluar arbitrarisht kërkesën që të kërkojë pension shtetëror, duke i kufizuar të drejtat sociale që i njeh legjislacioni në fuqi, sipas neneve 49 dhe 52 të Kushtetutës.

69. Sipas subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, ky pretendim i kërkeses nuk ka natyrë kushtetuese, pasi në mënyrë indirekte synon t’u jepet zgjidhje pretendimeve që lidhen me themelin e mosmarrëveshjes gjyqësore. Gjykata e Lartë ka vlerësuar drejt se gjendej përpara një vendimi të formës së prerë dhe përfundimtar, i cili e kishte zgjidhur përfundimisht mosmarrëveshjen e lindur midis palëve nga urdhri nr. 652/2013, duke u dhënë përgjigje kërtimeve dhe pretendimeve të tyre në proces. Kërkimet e reja të pretenduara si pasojë e këtij konflikti gjyqësor do të duhej të ngriheshin nëpërmjet mjeteve ligjore të ankimit dhe rekursit dhe jo me një padi të re. Kërkesja mund të mbrohej në Gjykatën e Lartë duke paraqitur kundërekurs, mjet të cilin ajo nuk e ka ushtruar dhe, për më tepër, nuk ka dhënë asnjë argument se përse nuk e ka ushtruar.

70. Subjekti i interesuar, Ministria e Brendshme, ka prapësuar se pretendimet e kërkeses për nxjerrjen e një urdhri të dytë nuk janë të bazuara, pasi ajo aktualisht nuk është as *de jure* dhe as *de facto* punonjëse efektive e Policisë së Shtetit që nga data e nxjerrjes së urdhrit të lirit nr. 652/2013 të ministrit të Brendshëm. Pretendimet e kërkeses janë të natyrës ligjore dhe nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues. Kërkesja është dëgjuar dhe ka pasur një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi.

71. Edhe subjekti i interesuar, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ka prapësuar se pretendimet e ngritura nga kërkesja nuk përbëjnë shkelje të normave kushtetuese, por janë pretendime që kanë marrë zgjidhje përfundimtare nga Gjykata e Lartë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka analizuar drejt shkaqet e ngritjes së padisë, duke

konkluduar se në rastin konkret jemi para “gjësë së gjykuar”. Pretendimet e kërkuases nuk janë të natyrës kushtetuese dhe ajo mund t’i drejtohet Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

72. Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë, funksioni i të cilit është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Gjykata e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve kushtetuese, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 17, datë 23.03.2023; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 18, datë 30.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

73. Gjithashtu, Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar lidhjen që siguria juridike ka me të drejtën kushtetuese të procesit të rregullt ligjor, në të cilën ky parim, përgjithësisht, shfaqet në formën e gjësë së gjykuar. Mosrespektimi i gjësë së gjykuar shkakton cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues e ligjorë, të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra cenon vetë sigurinë juridike. Në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton se kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, atëherë asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padi kundrejt të njëjtave palë (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 17, datë 30.03.2021; nr. 50, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

74. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi, duke kërkuar shfuqizimin e urdhrit nr. 652/2013, detyrimin e palës së paditur ta dëmshpërblejë me pagën që do të përfitonte deri në plotësimin e mandatit 4-vjeçar të zëvendës drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, si edhe detyrimin e palës së paditur që në datën 05.01.2016, që përkon me përfundimin e këtij mandati, ta trajtojë sipas nenit 25, pika 2, të ligjit nr. 9749/2007. Me vendimin gjyqësor të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit është vendosur anulimi i urdhrit nr. 652/2013 dhe detyrimi i palës së paditur, Ministrisë së Brendshme, të dëmshpërblejë kërkuësen me pagën mujore deri në datën 05.01.2016, kur i mbaron mandati i saj 4-vjeçar si zëvendës drejtor e përgjithshme e Policisë së Shtetit. Ky vendim është vënë në ekzekutim nga kërkuësja nëpërmjet shërbimit përmbarimor privat.

75. Kërkuësja, duke pretenduar se mandati i qëndrimit në detyrë ishte deri në datën 05.01.2016 dhe se ligjërisht nuk ekziston asnjë urdhër lirimi për të, ka kërkuar nxjerrjen e një urdhri të tillë, si dhe kryerjen e pagesës kalimtare për shkak të ndërprerjes së marrëdhënieve

të punës me Policinë e Shtetit. Për shkak të refuzimit të kërkesës së saj nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, kërkesja ka paraqitur një padi tjetër në gjykatë, duke kërkuar detyrimin e palëve të paditura, Ministrisë së Brendshme dhe Drejtorisë së Policisë së Shtetit, të nxjerrin urdhrin për nxjerrjen në lirim të saj, të trajtojnë kërkesën me pagesë kalimtare, të kryejnë pagesat e përcaktuara në urdhrat e përmbaruesit gjyqësor, si edhe t'i njohin periudhën 20.11.2013-05.01.2016 për efekt të pensionit të parakohshëm të pleqërisë, sipas legjislacionit përkatës.

76. Gjkata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 874 (80-2016-890), datë 29.02.2016 ka vendosur rrëzimin e padisë, duke arsyetuar se në procesin e mëparshëm gjyqësor, Gjkata Administrative e Apelit kishte shfuqizuar urdhrin nr. 652/2013 të lirimimit të kërkuësës nga detyra, ndaj nuk kishte hapësirë diskutimi për një tjetër disponim me urdhër lirimi me shkak të ligjshëm. Sipas gjykatës, kur urdhri i lirimimit është shfuqizuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, pretendimi që të disponohet me një urdhër të dytë lirimi, për të njëjtin fakt të gjykuar (lirim për të njëjtin motivacion, pasi nuk ka ndonjë rrethanë tjetër të verifikuar që të impononte lirimin), do të binte në kundërshtim me efektet ekzekutive të vendimit gjyqësor. Po kështu, Gjkata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vlerësuar se kërkitimi për të përfituar pagesë kalimtare, sipas nenit 12 të ligjit nr. 10142/2009, përbën “*res judicata*”, pasi ka qenë objekt i shqyrtimit gjyqësor dhe për të është disponuar me vendim të formës së prerë.

77. Vendimi është ndryshuar nga Gjkata Administrative e Apelit, e cila me vendimin nr. 3604, datë 12.10.2018, ka pranuar kërkitimet e padisë së kërkuësës, që lidheshin me nxjerrjen e urdhrat të lirimimit nga detyra, trajtimin me pagesë kalimtare dhe njohjen e periudhës për efekte të pensionit të parakohshëm, si dhe atij suplementar të pleqërisë.

78. Mbi bazën e rekursit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Gjkata e Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1854 (240), datë 16.06.2022, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Ajo ka arsyetuar se mosmarrëveshja e palëve e krijuar nga urdhri nr. 652/2013 ishte zgjidhur me vendim të formës së prerë dhe përfundimtar, ndaj kërkitimet e reja për këtë mosmarrëveshje duhej të ishin ngritur nëpërmjet mjeteve ligjore të ankimit dhe rekursit dhe jo me një padi të re, siç ka vepruar kërkuësja (*shih paragrafin 23 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

79. Për sa më lart, Gjkata vlerëson se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk rezulton të jetë alogjik ose të ketë kundërthënie dhe pjesa arsyetuese e tij lidhet me përfundimin e arritur në dispozitiv, duke plotësuar kështu kërkesat kushtetuese që kërkon standardi i arsyetimit të

vendimit gjyqësor. E drejta e kërkuases për pagesë kalimtare ka qenë objekt i gjykimit të parë që zgjidhi mosmarrëveshjen gjyqësore për urdhrin e lirimit. Në atë gjykim, gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit anuluan urdhrin e lirimit, por rrëzuan kërkimet për pagesën kalimtare dhe trajtimin suplementar të kërkuases, ndërsa ajo nuk paraqiti rekurs për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Gjithashtu, Gjukata vëren se Gjukata e Lartë në gjykimin e parë, duke lënë në fuqi vendimin për anulimin e urdhrin të lirimit, ka pranuar se ndërprerja e marrëdhënieve të punës së kërkuases me Policinë e Shtetit ishte e paligjshme, duke arsyetuar se, si pasojë, kërkuases i lindnin të drejtat e dëmshpërblimit financiar dhe të rikthimit në detyrë. Kjo e drejtë e fundit nuk u rivendos për kërkuasen për shkak se ajo nuk kishte paraqitur rekurs ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit. Në këtë mënyrë, marrëdhënia e saj e punësimit nuk u rivendos as *de jure* dhe as *de facto*, që më pas të ndërpritej me shkak të ligjshëm me urdhër lirimi nga detyra, siç pretendon kërkuasja, që të siguronte më pas përfitimet financiare të njohura nga ligji. Në këto rrethana, interpretimi i fakteve dhe zbatimi i ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për nxjerrjen e përfundimit se kërkimi për të drejtën e pagesës kalimtare ishte gjë e gjykuar, nuk rezultoi të ketë qenë i padrejtë dhe të ketë ndikuar në të drejtën kushtetuese të kërkuases për të pasur një proces të rregullt ligjor, në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit. Për rrjedhojë, Gjukata çmon se edhe pretendimi i kërkuases për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor i lidhur me parimin e sigurisë juridike është i pabazuar.

80. Në përfundim, Gjukata vlerëson se pretendimet e kërkuases janë të pabazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjukata Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronjat “a” dhe “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 12.06.2023

Shpallur më 12.07.2023

MENDIM PARALEL

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes nr. 24 (A) 2022, që i përket kërkuases Anila Hoxha, me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 240, datë 16.06.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe parashikimeve të nenit 482, paragrafi 3, të KPC-së, si dhe nenit 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, si të papajtueshme me Kushtetutën, edhe pse bashkohemi me shumicën për zgjidhjen e kësaj çështjeje, kemi qëndrim të ndryshëm për disa nga shkaqet mbi të cilat është arritur në këtë përfundim. Më konkretisht, në vlerësimin tonë, vetëm në lidhje me atë pjesë të objektit të kërkesës që ka të bëjë me shfuqizimin e dispozitave, mbajmë qëndrimin se vlerësimi i Gjykatës duhej të ishte ndalur në çështjen e legjitimitetit të kërkuases, pa vijuar më tej me bazueshmërinë në themel të pretendimeve të saj.

2. Në mënyrë të përmbledhur, nga rrethanat e çështjes rezulton se kërkuësja ka ngritur padi në gjykatë, me objekt shfuqizimin e urdhrit nr. 652/2013 të ministrit të Brendshëm dhe detyrimin e Ministrisë së Brendshme, si dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për dëmshpërblim me pagën që do të përfitonte deri në plotësimin e mandatit 4-vjeçar si zëvendës drejtoreshë e përgjithshme e Policisë së Shtetit, si dhe trajtimin në përputhje me pikën 2 të nenit 25 të ligjit nr. 9749/2007, deri në datën e përfundimit të mandatit, me pretendimin se lirimi i saj nga detyra ishte bërë në kundërshtim me ligjin, në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe të justifikuara. Kjo padi është pranuar pjesërisht nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, e cila, me vendimin nr. 223, datë 27.01.2014, ka vendosur detyrimin e Ministrisë së Brendshme ta dëmshpërblejë kërkuësen me pagën mujore deri në datën 05.01.2016, duke rrëzuar kërkimet e tjera. Vendimi është ndryshuar pjesërisht nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila, me vendimin nr. 1164, datë 01.04.2014, ka vendosur të pranojë edhe kërkimin për anulimin e urdhrit nr. 652/2013. Mbi bazën e rekursit të paraqitur nga palët e paditura dhe kundërrekursin e paraqitur nga kërkuësja, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2016-3211 (592), datë 20.12.2016, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit. Edhe pse ka arsyetuar se gjykatat më të ulëta duhet të kishin urdhëruar, krahas dëmshpërblimit me pagën deri në përfundim të mandatit 4-vjeçar, edhe sistemimin e kërkuases në detyrën e mëparshme ose në një detyrë tjetër të të njëjtit nivel dhe gradë, duke konstatuar se ajo nuk kishte paraqitur rekurs, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se nuk mund të vendoste rikthimin në punë të kërkuases.

3. Në vijim, kërkuësja ka inicuar një proces tjetër (procesi objekt kërkesë) për detyrimin e Ministrisë së Brendshme dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për nxjerrjen e urdhrit për lirimin nga detyra, trajtimin me pagesë kalimtare, njohjen e

periudhës 20.11.2013 - 05.01.2016 për efekt të pensionit të parakohshëm dhe pensionit suplementar të pleqërisë sipas ligjit, si dhe kryerjen e pagesave të përcaktuara në urdhrat e përmbaruesit gjyqësor. Me vendimin nr. 874 (80-2016-890), datë 29.02.2016, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se mosmarrëveshja përbënte gjë të gjykuar, vendim që është ndryshuar nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila, me vendimin nr. 3604, datë 12.10.2018, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë, duke e detyruar Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit të nxjerrë urdhrin e lirimit të kërkueses, trajtimin e saj me pagesë kalimtare sipas ligjit nr. 108/2014, njohjen e periudhës 20.11.2013-05.01.2016 për efekt të pensionit të parakohshëm dhe pensionit suplementar të pleqërisë. Në lidhje me pjesën tjetër të kërtimeve është vendosur rrëzimi i tyre.

4. Mbi bazën e rekursit të palës së paditur në proces, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1854 (240), datë 16.06.2022, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke arsyetuar se vendimi gjyqësor për anulimin e urdhrin të lirimit dhe zgjidhjen e pasojave të tij është i formës së prerë dhe ka efekte juridike me natyrë ekzekutuese për mosmarrëveshjen në proces, ndaj ajo përbën gjë të gjykuar.

5. Pasi është njohur me këtë vendim kërkuesja ka paraqitur ankim kushtetues individual, duke kundërshtuar jo vetëm vendimin e Gjykatës së Lartë, por edhe përmbajtjen e nenit 482, pika 3, të KPC-së, që parashikon se *“Sekretaria e Gjykatës së Lartë shpall listat e shqyrtimit të rekurseve të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit”*, dhe nenit 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 që parashikon se *“Sekretaria e gjykatës njofton me shpallje ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, si dhe përbërjen e trupit gjykues të paktën 15 ditë përpara”*. Në mbështetje të këtij kërkimi ajo ka pretenduar se këto dispozita ligjore nuk parashikojnë njoftimin individual të palëve dhe zbatimi i tyre i ka cenuar të drejtën për t’u njoftuar rregullisht, të drejtën për t’u dëgjuar e për t’u mbrojtur në Gjykatën e Lartë.

6. Në lidhje me legjitimitimin e kërkueses për kundërshtimin e dispozitave ligjore, shumica ka vlerësuar se procesi gjyqësor i kërkueses është me natyrë administrative, ndaj mënyra e njoftimit të palëve për gjykimin në Gjykatën e Lartë rregullohet nga ligji nr. 49/2012, dispozita të cilat plotësohen nga KPC-ja. Kështu, sipas nenit 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, *“Sekretaria e gjykatës njofton me shpallje ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, si dhe përbërjen e trupit gjykues të paktën 15 ditë përpara”*. Në të njëjtën linjë, fjalia e parë e nenit 482, paragrafi 3, i KPC-së parashikon se *“Sekretaria e Gjykatës së Lartë shpall listat e shqyrtimit të rekurseve të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit”* dhe më tej, po ky paragraf

parashikon se njoftimi për ditën, orën, si dhe përbërjen e trupit gjykues që shqyrton rekursin bëhet me shpallje në ambientet e Gjykatës së Lartë, si dhe në faqen e saj të internetit dhe me njoftim individual, kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjyqimit. Në këtë drejtim, shumica ka vlerësuar se neni 482, paragrafi 3 i KPC-së dhe neni 61, pika 2, i ligjit nr. 49/2012, që kundërshtohen nga kërkesja, nuk parashikojnë nxjerrjen e akteve nënligjore dhe zbatohen drejtpërdrejt nga Gjykata e Lartë në procesin që ajo zhvillon, duke përmbyllur në këtë mënyrë kushtin e efektit të drejtpërdrejtë, që parashikohet nga neni 49, pika 3, shkronja “e”, i ligjit nr. nr. 8577/2000. Ky kuadër ligjor është përdorur nga Gjykata e Lartë për të kryer njoftimin e kërkeses për çështjen e saj, duke shpallur në faqen zyrtare dhe në këndin e njoftimeve në ambientet fizike listën e gjykimeve për seancat gjyqësore, si dhe përbërjen e trupit gjykues, ku përfshihet edhe çështja e kërkeses. Për rrjedhojë, kërkesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar (*shih paragrafët 31-32 të vendimit*).

81. Në lidhje me këtë qëndrim ne ndahemi nga shumica, pasi vlerësojmë se kërkesja legjitimohet *ratione personae* vetëm për kundërshtimin e vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar. Ndërsa, për sa i përket kërimit për shfuqizimin e dispozitave ligjore të KPC-së dhe ligjit nr. 49/2012, për mënyrën e njoftimit me shpallje në ambientet fizike të Gjykatës së Lartë, në kushtet kur ajo ka dhënë adresën e saktë të banimit dhe numrin e telefonit, çmojmë se ajo nuk legjitimohet *ratione personae*.

82. Në vlerësimin tonë, pretendimet e kërkeses nuk janë ngritur në nivel kushtetues, duke mos arritur të provojë cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, për shkak të përmbajtjes së këtyre parashikimeve ligjore dhe mënyrës se si ato kanë përcaktuar njoftimin e palëve për procesin gjyqësor që zhvillohet në Gjykatën e Lartë. Në kuptim të parashikimeve të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 49, pika 3, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577/2000, kërkesi duhet të provojë se *cenimi i të drejtave themelore është real dhe jo hipotetik*. Në mënyrë që të pretendojë se është viktimë e një shkeljeje kërkesi duhet të provojë se është prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga masa e kundërshtuar dhe, në këtë kuptim, në rastin konkret, kërkesja nuk ka arritur të argumentojë cenimin e të drejtave të saj të garantuara kushtetutshmërisht nga përmbajtja e normave të kundërshtuara, pra se parashikimi i tyre për mënyrën se si procedon Gjykata e Lartë për

njoftimin për datën e zhvillimit të gjykit cenon thelbin e së drejtës së saj për t'u njoftuar dhe për t'u dëgjuar.

83. Gjykata ka një jurisprudencë të konsoliduar për mbrojtjen e garancive të procesit të rregullt ligjor në drejtim të njoftimit dhe pjesëmarrjes në proces të palëve ndërgjyqëse, duke verifikuar për këtë qëllim rregullsinë e procedurave të njoftimit të ndjekura nga Gjykata e Lartë. Në një numër të konsiderueshëm rastesh të ankimeve kushtetuese individuale, që kanë pasur në objektin e tyre këtë pretendim, Gjykata, pavarësisht nëse çështja është shqyrtuar në seancë publike ose mbi bazë të dokumenteve, nga pikëpamja faktike ka verifikuar, rast pas rasti, nëse njoftimi është realizuar në mënyrat e domosdoshme të përcaktuara nga ligji – me anë të shpalljes në ambientet fizike dhe shpalljes në faqen elektronike. Kur është konstatuar se njoftimi për datën e zhvillimit të seancës në Gjykatën e Lartë nuk ka qenë i shpallur në faqen e saj elektronike, Gjykata e ka pranuar pretendimin për cenimin e procesit të rregullt ligjor, duke argumentuar se sekretaria e Gjykatës së Lartë ka detyrimin për njoftimin e rregullt të palëve, në mënyrë që ato të mund të marrin pjesë në gjykim, si dhe të dëgjohen, qoftë edhe mbi bazë të dokumenteve, me anë të paraqitjes së komenteve ose prapësimeve, me qëllim garantimin e së drejtës së mbrojtjes, barazisë së armëve në gjykim dhe kontradiktoritetit (*shih vendimet nr. 20, datë 22.09.2022; nr. 17, datë 01.03.2017; nr. 76, datë 16.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Madje, Gjykata ka pohuar se njoftimi i datës dhe orës së gjykit është një akt i domosdoshëm procedural, që merr rëndësi për më tepër në rastin kur Gjykata e Lartë ka ndryshuar dy vendimet e gjykatave më të ulëta dhe ka rrëzuar padinë e kërkuarit. Në këtë rast, moskomunikimi i zhvillimit të seancës nga ana e administratës gjyqësore, në përputhje me rregullat procedurale për zhvillimin e gjykit administrativ, sjell mospërfitimin e garancive ligjore të kërkuarit për njohjen në kohë të pretendimeve të palës tjetër dhe kundërshtimin e tyre nëpërmjet paraqitjes së argumenteve, kjo me qëllim shmangien e vënies në një pozitë të pafavorshme në raport me atë palë (*shih vendimin nr. 65, datë 07.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

84. Në rastin konkret nuk jemi përpara mungesës së njoftimit, pasi ai është realizuar nga Gjykata e Lartë, bazuar pikërisht në parashikimin e dispozitave të kundërshtuara, si në faqen elektronike zyrtare të Gjykatës së Lartë, ashtu edhe në këndin e njoftimeve në ambientet fizike të saj, pra me afishim, duke plotësuar në këtë mënyrë kërkesat ligjore për këtë qëllim.

85. Për sa më sipër, nuk pajtohem me argumentin e shumicës, që ka shërbyer për legjitimitimin e kërkuarit për këtë kërkim të ankimit kushtetues individual. Rëndësia e njoftimit të palëve për zhvillimin e gjykit, përfshirë atë të Gjykatës së Lartë, dhe forcimi i garancive për realizimin e njoftimit efektiv, janë përkrahur edhe nga zhvillimet legislative dhe praktika

e punës së gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në vitin 2012 ligji për organizimin e gjykatave administrative e, më tej, ndryshimet në KPC, në vitin 2017, kanë parashikuar përdorimin e mjeteve elektronike gjatë procesit, ku, krahas njoftimit me shpallje në ambientet fizike, realizohet edhe njoftimi në faqen elektronike të gjykatës, si dhe njoftimi individual i drejtpërdrejtë, në rastin kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit. Këto rregulla kanë rritur efikasitetin e njoftimit, duke mundësuar si thjeshtimin e procedurave, ashtu edhe përshpejtimin e gjykimit të çështjeve. Në të njëjtën linjë, Gjykata e Lartë, me urdhrin e datës 02.07.2021, ka përcaktuar detyrimin e sekretarisë gjyqësore që, përveç afishimit në këndin e njoftimit dhe shpalljes në faqen elektronike, të kryejë edhe njoftimin elektronik në adresat e postës elektronike të palëve. Në ndryshim nga shumica, vlerësojmë se kjo mënyrë njoftimi nëpërmjet përdorimit të mjeteve elektronike i përgjigjet zhvillimit aktual shoqëror dhe se krijon mundësi komunikimi dhe aksesit në kohë reale dhe të garantuar.

86. Në këtë kontekst, vlerësojmë se kërkesja nuk ka arritur të provojë në nivel kushtetues se mënyra e njoftimit që parashikojnë dispozitat e kundërshtuara, nëpërmjet shpalljes në ambientet fizike të Gjykatës së Lartë dhe faqen elektronike, nuk arrin të sigurojë njoftimin e duhur të palëve në proces dhe se nuk garanton marrjen e tyre dijeni për procesin. Ajo nuk ka arritur të provojë, gjithashtu, se kjo mënyrë njoftimi krijon pengesa të tilla që çojnë në mohimin e të drejtave të palëve në proces.

87. Në përfundim, vlerësojmë se, për sa kohë që kërkesja nuk ka arritur të provojë se në çfarë mënyre është cenuar në të drejtën e saj kushtetuese për proces të rregullt ligjor, duhej të ishte vendosur mungesa e legjitimitetit *ratione personae* për këtë kërkim të objektit të ankimit kushtetues individual.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Genti Ibrahim, Sonila Bejtja

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkueses Anila Hoxha, me objekt: *“Shfuqizimi i vendimit nr. 240, datë 16.06.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Shfuqizimi i fjalisë “Sekretaria e Gjykatës së Lartë shpall listat e shqyrtimit të rekurseve të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit”, në nenin 482, paragrafi 3, të Kodit të Procedurës Civile, si e papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Shfuqizimi i fjalisë “Sekretaria e gjykatës njofton me shpallje ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, si dhe përbërjen e trupit gjykues të paktën 15 ditë përpara”, në nenin 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, si e papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”, jam kundër vendimit të shumicës për rrëzimin e kërkesës, pasi vlerësoj që ajo duhej të ishte pranuar për shkak se të paktën një prej pretendimeve të kërkueses ishte i bazuar. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese, parashtroj në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin kundër.*

2. Në rastin konkret, çështja e kërkueses, e cila kishte në objekt të drejtat nga marrëdhënia e punësimit të zgjidhur në mënyrë të paligjshme, ishte regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 26.12.2018, bazuar në rekursin e paraqitur nga pala kundërshtare e saj, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Në aktet drejtuar gjykatës kërkuessa kishte depozituar numrin e saj të telefonit celular, ndërsa nuk kishte paraqitur adresën e postës elektronike. Çështja e kërkueses është vënë në lëvizje në Gjykatën e Lartë pas 3 vjetësh e 6 muaj, kur relatori i çështjes, me vendimin e datës 24.05.2022, ka caktuar datën 15.06.2022 për shqyrtimin e saj në dhomën e këshillimit, duke urdhëruar njëkohësisht edhe sekretarinë gjyqësore të kryente njoftimin e palëve. Sekretaria gjyqësore ka proceduar sipas neneve 482, pika 3, të KPC-së dhe 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, që kundërshtohen nga kërkuessa, duke afishuar aktin e njoftimit në ambientet fizike të Gjykatës së Lartë në datën 31.05.2022, si dhe duke e publikuar atë edhe në faqen zyrtare, në rubrikën *“Çështje të shpallura për gjykim”*, për kategorinë *“Çështje administrative”*, nënrubrika *“Për shqyrtim në dhomë këshillimi”*. Në dosjen e Gjykatës së Lartë është administruar njoftimi se shqyrtimi i çështjeve të shpallura për gjykim në datën 15.06.2022, në dhomën e këshillimit, shtyhet për datën 16.06.2022. I njëjti njoftim është publikuar edhe në faqen zyrtare, në rubrikën *“Njoftime për publikun”*, në datën 15.06.2022, me emërtimin *“Informacion për shtyrjen e çështjeve administrative të planifikuara për shqyrtim në dhomë*

këshillimi” përmes të cilit njoftohet se: “*Të gjitha çështjet administrative të shpallura për shqyrtim në dhomë këshillimi, datë 15.06.2022, do të shtyhen për në datën 16.06.2022.*”. Në procesverbalin e shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit, që mban datën 16.06.2022, ora 9:20, është shënuar se palët ndërgjyqëse kanë marrë dijeni rregullisht sipas ligjit nëpërmjet shpalljes së datës 31.05.2022 dhe nuk rezulton të kenë paraqitur ndonjë kërkesë procedurale për përjashtimin e trupit gjykues. Në përfundim, Gjykata e Lartë ka vendosur në disfavor të kërkueses, duke prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

3. Mbi këto fakte, kërkuësja ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të të drejtave për t’u njoftuar, mbrojtur dhe dëgjuar - të analizuara në këndvështrim të së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për mbrojtje efektive, si dhe të standardit të arsyetimit të vendimit në lidhje me parimin e sigurisë juridike për konceptin e gjësë së gjykuar, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës.

4. Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën e mbrojtjes efektive, për shkak të mënyrës së zbatimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, shumica ka vlerësuar se është i pabazuar (*shih paragrafin 67 të vendimit*). Sipas saj, Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me dispozitat procedurale për njoftimin e palëve me anë të shpalljes në këndin e njoftimeve në ambientet fizike të saj, si dhe në faqen elektronike zyrtare, ndaj kërkuësja është njoftuar rregullisht dhe i është dhënë mundësia për t’u mbrojtur. Në nxjerrjen e këtij përfundimi, shumica ka mbajtur në konsideratë edhe disa faktorë: (i) kërkuësja kishte marrë njoftim individual për rekursin, në kuptimin që ishte njohur me pretendimet e palës kundërshtare; (ii) përbërja e kolegjit të Gjykatës së Lartë që ka shqyrtuar çështjen e kërkueses është publike dhe e aksesueshme në faqen zyrtare elektronike, ndërsa ajo nuk ka parashtruar ndonjë rrethanë konkrete në drejtim të paanësisë së anëtarëve të trupit gjykues; (iii) dhe numri i telefonit celular, që ishte depozituar nga kërkuësja në aktet drejtuar gjykatës, nuk përfshihet në konceptin e të dhënës së kontaktit “adresë e postës elektronike”, referuar përmbajtjes së urdhrit administrativ nr. 131/2021 (*shih paragrafët 63, 64 dhe 66 të vendimit*).

5. Nuk pajtohem me këtë qëndrim të shumicës, sidomos me vlerësimin që ajo i ka bërë konceptit të mjetit elektronik të njoftimit, duke përjashtuar prej tij telefonin celular. Njoftimi i individit për procesin gjyqësor nuk duhet të konceptohet dhe as të zbatohet si një detyrim për përmbushjen e përciptë të rregullave procedurale, sepse siç pranon shumica, nëse individi nuk njoftohet, ai detyrimisht gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor (*shih paragrafin 46 të vendimit*). Për këtë arsye, çmoj se është detyrë kushtetuese e gjykatave të kujdesen për

efektivitetin e akteve të njoftimit, në përputhje me parimin e përgjithshëm të sanksionuar nga neni 15, pika 2, i Kushtetutës, sipas të cilit organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre. Ky detyrim, në rastin e procesit të rregullt ligjor, ka lidhje edhe me dinjitetin njerëzor, që, sipas nenit 3 të Kushtetutës, përbën vlerë themelore të rendit tonë juridik. Në këtë kuptim, e drejta për proces të rregullt ligjor përbën kusht *sine qua non* për respektimin e dinjitetit njerëzor, sepse i jep mundësinë individit të dëgjohet, të ketë gjykim të drejtë dhe të riparojë të drejtat dhe interesat që eventualisht i janë shkelur.

6. Nën këtë perspektivë, pretendimi i kërkueses se Gjykata e Lartë, me mënyrën se si i ka zbatuar normat ligjore për njoftimin e kërkueses është i bazuar për dy arsye kryesore.

7. *Së pari*, Gjykata kur ka analizuar pretendimin tjetër të kërkueses për pajtueshmërinë e me Kushtetutën të normave ligjore, ka arritur në përfundimit se kufizimi është proporcional (shih paragrafin 57 të vendimit), duke arsyetuar se “*njoftimi me shpallje shoqërohet edhe me mundësinë e njoftimit individual, kur vetë individi depoziton të dhënat elektronike të kontaktit të tij. Lidhur me këtë të fundit, në kushtet e zhvillimit të sotëm shoqëror, ku individi ka qasje të lehtë në internet dhe mjete elektronike, Gjykata vlerëson se bëhet fjalë për mundësi reale në dispozicion të individit, i cili me vullnetin e tij të lirë zgjedh, që krahas shpalljes publike, të njoftohet edhe individualisht*”. Duke qenë dakord me këtë pjesë të vendimit, çmoj se i njëjti standard duhej zbatuar edhe në analizën e këtij pretendimi të kërkueses dhe të nxirrej përfundimi se Gjykata e Lartë duhej ta kishte njoftuar individualisht kërkuesen, në kushtet kur ajo kishte depozituar të dhënën elektronike, “*numrin e telefonit celular*”.

8. Në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor, gjykata ka detyrimin që të bëjë të gjitha përpjekjet e duhura që individi të njoftohet efektivisht për procesin që zhvillohet ndaj tij. Njoftimi me shpallje, edhe pse mund të jetë efektiv për ecurinë e procesit, nuk mund të mbizotërojë ndaj së drejtës për proces të rregullt, në kushtet kur mundësitë dhe mjetet për realizimin e saj dukshëm kanë evoluar. Zbatimi i ngurtë vetëm i kësaj mënyrë njoftimi, minon aftësinë e kërkuetit për të marrë pjesë në proces dhe për të mbrojtur interesat e tij.

9. *Së dyti*, garancitë për realizimin e njoftimit efektiv janë forcuar edhe nga zhvillimet e fundit legjislativë, si dhe nga praktika e punës së gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Ato u janë përgjigjur zhvillimeve të teknologjisë së informacionit, që kanë lehtësuar komunikimin në jetën e përditshme, pavarësisht distancave gjeografike. Në procedurat gjyqësore vlen të evidentohet përmbajtja e nenit 141 të KPC-së, i zbatueshëm edhe në gjykimin administrativ, i cili ka parashikuar njoftimin elektronik. Ashtu siç me të drejtë vëren shumica, njoftimi elektronik është një alternativë e re ligjore, përdorimi i së cilës duhet nxitur, pasi i përgjigjet jo

vetëm nevojës për shpejtësi në procedura, por edhe problematikave të shfaqura në jetën e përditshme nga lëvizjet demografike dhe sistemi i pakonsoliduar ende i adresave të qytetarëve (shih paragrafin 65 të vendimit).

10. Në këtë situatë, vlerësoj se Gjykata duhej t'u përgjigjej këtyre zhvillimeve dhe të pranonte se numri i telefonit celular përbën mjet komunikimi elektronik, sepse ai mundëson komunikimin e menjëhershëm të të dhënave nga njëri përdorues tek tjetri nëpërmjet mesazheve, por edhe nëpërmjet platformave sociale. Si i tillë, ai është pajisje e komunikimit elektronik, sepse shërben nga ana teknike për emetimin, transmetimin, rrugëzimin, komutimin dhe/ose marrjen e sinjaleve nëpërmjet valëve elektromagnetike. Në vlerësimin tim, ideja se komunikimi elektronik përfshin vetëm komunikimin me anë të postës elektronike është e varfër dhe nuk u përgjigjet zhvillimeve të sotme të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (*sikurse njihet në përditshmëri "TIK"*), të cilat garantojnë sigurimin e aksesit në informacione përmes telekomunikimit, përfshirë këtu internetin, celularët ose media të tjera komunikimi. Përdorimi i këtyre mjeteve i ka dhënë tashmë një dimension të ri ndërveprimit njerëzor, pasi nxit, realizon dhe motivon në kohë reale komunikimin dhe informimin për çështje që paraqesin rëndësi për individin dhe prekin interesat e tij, veçanërisht në procedura që ndryshojnë situatën juridike në raport me të drejtat dhe liritë themelore të tij. Nën këtë optikë, shmangia e disa mjeteve të komunikimit, të cilat janë të gjerësisht përdorshme nga individ, përbën një barrierë të ngurtë dhe të pakuptimtë.

11. Në rastin në shqyrtim, çështja e kërkueses ishte vënë në lëvizje nga pala kundërshtare e saj. Ndonëse çështja kishte në objektin e saj të drejta që lidheshin me zgjidhjen e paligjshme të marrëdhënies së punës së kërkueses, ajo është vënë në lëvizje pas 3 vjetësh e 6 muaj nga regjistrimi i saj. Në momentin që gjyqtari relator në Gjykatën e Lartë e vuri çështjen në lëvizje, njoftimi me shpallje publike zgjati vetëm 15 ditë (nga data 31.05.2022 në datën 15.06.2022), dhe në vijim, seanca në dhomën e këshillimit u shty për të nesërmen, ndaj njoftimi për këtë seancë të dytë qëndroi i shpallur vetëm një ditë. Edhe pse kërkuësja kishte depozituar numrin e telefonit celular, duke konfirmuar se kishte pritshmëri që njoftimet dhe komunikimet gjyqësore të realizoheshin nëpërmjet këtij mjeti, Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar individualisht kërkuësen. Me fjalë të tjera, pavarësisht se Gjykata e Lartë kishte mjete alternative në dispozicion për të realizuar njoftimin e kërkueses, sikurse komunikimi me telefon, ajo nuk e ka përdorur këtë mjet, duke vendosur një barrë tepër të rëndë për kërkuësen në drejtim të aksesit dhe mbrojtjes efektive.

12. Në përfundim, vlerësoj se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë në lidhje me të drejtën për mbrojtje efektive, të lidhur me mënyrën e zbatimit të ligjit,

është i bazuar, për rrjedhojë ankimi kushtetues individual i saj duhet të pranohet dhe të vendoset shfuqizimi i vendimit të Gjykatës së Lartë.

Anëtare: Marsida Xhaferllari